

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-147/2015

Prishtinë

7 Shkurt 2018

Në çështjen ligjore të:

V. M.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i trupit gjykues, Krassimir Mazgalov gjyqtar i EULEX-it dhe Isa Kelmendi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA22116), të datës 18 qershor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 7 Shkurt 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga V. M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 , të datës 18 qershor 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA22116, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014, i datës 18 qershor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numrin KPA22116, vërtetohet.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 29 janar 2007, V.M. (në tekstin e mëtutjeshëm: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) me anë të së cilës ka kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 7123/2 me sipërfaqe prej 0.19.98 ha, e cila gjendet në vendin e quajtur Buzagilak, Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar). Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA22116.
2. Pala ankuese pretendon se babai i tij S. M. i cili ka vdekur më 2 gusht 2004, e ka blerë pronën e kërkuar nga N. D. më 18 prill 1969, dhe se posedimin e saj e ka humbur më 16 qershor 1999 si rezultat i rrethanave që lidhen me konfliktin e armatosur në Kosovë në mes të viteve 1998 dhe 1999.
3. Në mbështetje të kërkesës së tij, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së dokumentet në vijim:
 - Kontratën e blerjes nr. ov.br.508/69 të datës 18 prill 1969 me të cilën bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore e ka blerë pronën e kërkuar nga D. N. Nënshkrimet e palëve janë vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren.
 - Ekstraktin e fletës poseduese të datës 5 qershor 1969 në të cilën bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore figuron si pronar i ngastrës kadastrale nr.7123/4 me sipërfaqe prej 0.06.00 ha.
 - Konfirmimin e fletës poseduese nr. no.br.952-01-2/96-302 të datës 4 shtator 1996 të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, ku konfirmohet se ngastra kadastrale nr.7123/2 me sipërfaqe prej 0.06.00 ha është regjistruar në emër të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore S. M. deri më 1986.

- Certifikatën e lindjes nr. 93/88 të lëshuar më 8 nëntor 2005 sipas të cilës babai i paraqitësit të kërkesës është bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore S.M..
 - Certifikatën e vdekjes nr. 40 për 2004 ku vërtetohet se bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore S.M. ka ndërruar jetë më 2 gusht 2004.
4. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së sipas *detyrës zyrtare* ka gjetur certifikatën mbi të drejtat e paluajtshme nr.7123/2 në të cilën NSH “Progres” figuron si bartës i së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar dhe certifikatën mbi të drejtat e paluajtshme nr.17458 në të cilën bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore figuron si pronar i ngastrës kadastrale nr.7770/12 me sipërfaqe prej 0.05.00 ha, por e cila gjendet në “Kalaja” dhe jo në “Buzagilak”.
 5. Nga dokumentet e përmendura në paragrafin 3 më lart, vetëm certifikata e vdekjes dhe certifikata e lindjes janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Verifikimi i kontratës së blerjes, ekstraktit të fletës poseduese dhe konfirmimi i fletës poseduese ka qenë negativ.
 6. Njoftimi fizik i pronës më 2008 ka qenë i pasuksesshëm. Më 2010 njoftimi dhe konfirmimi i kërkesës është bërë përmes publikimit në Gazetën Njoftuese të AKP-së nr..2 dhe në Zyrën Pronësore të UNHCR-së. Të dy publikimet janë vendosur më 28.12.2010 në dyert e hyrjes së Komunës së Prizrenit dhe Gjykatës Komonale të Prizrenit. Asnjë palë përgjegjëse nuk është paraqitur pranë Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së brenda afatit prej 30 ditësh siç është përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale.
 7. Më 18 qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KKPK) me vendimin e tij të vërtetuar KPCC/D/A/244/2014, ka refuzuar kërkesën. Në arsyetimin e vendimit në fjalë (paragrafët 60,61), KKPK-ja ka gjetur se asnjëri nga dokumentet e paraqitura nga paraqitësi i kërkesës nuk është vërtetuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së si të vërteta dhe sipas certifikatës mbi të drejtat e paluajtshme të marrë sipas detyrës zyrtare, prona e kërkuar është në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore. Prandaj, KKPK-ja ka konstatuar se e drejta pronësore e kërkuar nuk është vërtetuar.
 8. Më 31 tetor 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese. Më 1 dhjetor 2014, pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese pohon pretendon se vendimi i KKPK-së përmban gabime thelbësore, është në shkelje të rëndë të ligjit material dhe procedural dhe bazohet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendje së fakteve. Pala ankuese i propozon Gjykatës Supreme që ta aprovojë ankesën dhe të nxjerrë aktgjykim duke ia njohur palës ankuese të drejtën mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

10. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në pajtim me nenin 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 194 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gjykata gjeti se Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
11. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i ankesës ka të drejtë në një urdhër për ri posedimin e pronës nëse paraqitësi i ankesës dëshmon të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, dhe se ai nuk ka qenë në gjendje ta ushtojë të drejtën e tillë pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
12. Pala ankuese, të drejtën e tij pronësore e bazon në dokumentet të cilat nuk janë gjetur pranë zyrave përkatëse në Kosovë. Shënimet kadastrale e tregojnë atë pjesë të pronës së kërkuar të regjistruar si pronë shoqërore.
13. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se të drejtat e pretenduara pronësore nuk janë vërtetuar nga pala ankuese dhe se nuk ekziston asnjë provë se prona e kërkuar ka qenë në posedim të palës ankuese.
14. Gjykata Supreme e konsideron të drejtë përfundimin e KKPK-së se pala ankuese nuk e ka vërtetuar të drejtën e tij pronësore mbi pronën e kërkuar dhe humbjen e kësaj të drejte menjëherë para apo gjatë konfliktit të vitit 1998-1999 dhe për këtë arsye kërkesa e tij është refuzuar.

15. Në fund, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se vendimi i kundërshtuar i KKPK-së është lëshuar pas vërtetimit të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike dhe mbi këtë bazë ligji material dhe procedural janë zbatuar në mënyrë të drejtë. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.
16. Duke marr parasysh atë që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme.

Beshir Islami, kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Isa Kelmendi, gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam , referent i EULEX-it